

Legjionaret/ Sadiku shenon per Luganon

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 26 Shtator 2013 21:01



Armando Sadiku nuk di te ndalet kur vjen puna tek goli. Sulmuesi shqiptar ka firmosur serish per skuadren e Luganos. Ekipi ku luan sulmuesi i kombetares nuk e ka shmangur dot humbjen ne fushen e Vaduzit. Armando Sadiku shenoi golin e vetem ne humbjen 2-1 qe Lugano mori ne ndeshjen e rradhes ne kampionat dhe pas ketij takimi renditet ne vendin e tete. Sadiku pret me padurim janarin per tu larguar nga kategoria e dyte ne Zvicer por nderkohe vazhdon te bej mjaft mire per skuadren e Luganos.